



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 8, datë 10.02.2026

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR TRAJTIMIN E GRAVE/VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË PAJISUR ME URDHËR MBROJTJE, ME STREHIM TË MENJËHERSHËM

Në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, Direktivës (BE) 2024/1385, datë 14.05.2024, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqes familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 “ Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, si dhe sipas

relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e procedurës së përshpejtuar për trajtimin me strehim të menjëhershëm dhe/ose subvencionim qiraje të grave/viktimave të dhunës në familje, të cilat ndodhen në situatë rreziku ose nevojë emergjente për strehim, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe nevojës sociale, të kryer nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të bashkisë Durrës, të pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykata.
2. Procedura e përshpejtuar dhe masat e strehimit/subvencionimit zbatohen si masa mbrojtëse, parandaluese dhe riintegruese, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Direktiva (BE) 2024/1385, duke garantuar akses të menjëhershëm dhe efektiv në shërbime mbështetëse, pa barriera procedurale apo kushtëzime disproporcionale.
3. Subvencionimi i qirasë miratohet për aq sa është parashikuar në urdhërin e mbrojtjes, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kriterëve ligjorë parashikuar në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

BASHKIM DURRE
19.02.26 1680/9

Nr. 140/8 prot.

Durrës, më 19.02.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.08 datë 10.02.2026 ,” Për miratimin e procedurës së përshpejtuar për trajtimin e grave/viktimave të dhunës në familje të pajisur me urdhër mbrojtje, me strehim të menjëhershëm”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

